VENDIM
Nr. 847, datë 18.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetar
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtar,

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun e Elbasanit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Edmond Haxhinasto.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 164, pika 2 i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7340 prot., datë 17.12.2012, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Edmond Haxhinasto, deputet i zonës zgjedhore qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 30, datë 2.8.2013 "Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013". Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun e Elbasanit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Edmond Haxhinasto, me numër rendor 2 (dy) Bujar Kllogjri.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit vijues të listës së Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zonën zgjedhore qarku Elbasan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013 "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Edmond

Haxhinasto, me numër rendor 2 (dy) Bujar Kllogjri.

Sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, kandidati i cili renditet me numër rendor 3 (tre), është zonja Miranda Rexhep Rira. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit, të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Edmond Haxhinasto, është znj. Miranda Rexhep Rira, e cila renditet përkatësisht me numër rendor 3 (tre).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a" dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim qarku Elbasan, znj. Miranda Rexhep Rira.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.